



KTV
Berat BICAJ
Drejtor
Prishtinë

Rasti Nr. 2019/31
Ref:1907/938/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2019/31 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për KTV (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës përgjegjëse me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 ka iniciuar monitorimin ex officio të raportimit të Policisë së Republikës së Kosovës në veriun e vendit të transmetuar në lajmet qendror të Palës përgjegjëse me datat 28 dhe 29 maj 2019. Fokus i monitorimit ishte mënyra e raportimit dhe paraqitja e arrestimit të të dyshuarve.
3. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 30 maj 2019 ka gjetur se Pala përgjegjëse gjatë raportimit të kësaj ngjarjeje ka transmetuar video në të cilat është bërë zbulimi dhe identifikimi i të dyshuarve, veprim ky i cili është në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.
4. KPM pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 11 qershor 2019 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM 2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës. Po ashtu, i ka ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh, pas pranimit të shkresës, të përgjigjet dhe të ofrojë sqarim në raport me shkeljet e gjetura.
5. KPM brenda afatit të paraparë nuk ka pranuar asnjë përgjigje nga Pala përgjegjëse.

Analiza ligjore

6. Komisioni i KPM-së bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 2 dhe 3, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Neni 7, paragrafi 2, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përcakton se:

“OSHM-të respektojnë të drejtën e individit që të konsiderohet i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia nga gjykata kompetente.”

Neni 7, paragrafi 3, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përcakton se:

“OSHM-të nuk duhet të transmetojnë materiale që identifikojnë personat e arrestuar apo ndaluar që sulmohen fizikisht apo verbalisht në mënyrë që i përul apo poshtëron ata.”

7. Komisioni gjatë monitorimit ka gjetur se Pala përgjegjëse gjatë raportimit të kësaj ngjarjeje ka transmetuar video, në të cilat është bërë zbulimi dhe identifikimi i të dyshuarve të arrestuar.
8. Komisioni duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 7, paragrafi 2, dhe 3, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Vendim

9. Pala përgjegjëse sanksionohet me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 7, paragrafi 2, dhe 3, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
10. Obligohet Pala përgjegjëse që në të ardhmen t'i kushtojë kujdesin e duhur mbrojtjes së identitetit dhe integritetit të personave të dyshuar në mënyrë që të veprojnë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03.

E drejta për ankesë

11. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i Vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
12. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysht vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Muja FERATI
Kryetar



30.07.2019
Datë